



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.3880/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-kundërpaditurit Komuna e Dragashit, e përfaqësuar sipas autorizimit nga I.R, nga Dragashi, kundër të paditurës-kundërpaditëses Z. E nga fshati “.....”, Komuna e Dragashit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat A. K, nga Prizreni, për shkak të pasurimit pa bazë dhe objekt të kundërpadisë kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës-kundërpaditëses të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Dragash, C.nr.105/12, të datës 06.05.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **28.04.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës-kundërpaditëses Z.E, nga fshati “.....”, Komuna e Dragashit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Dragash, C.nr.105/12, i datës 06.05.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.105/12, të datës 06.05.2020, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses-kundërpaditurës Komuna e Dragashit, dhe e ka detyruar të paditurën-kundërpaditësen Z.E nga fshati “.....”, Komuna e Dragashit që të kthej shumën prej 6.634,70 €, e cila shumë përfshinë vitin 2010, 2011 e deri në shtator 2012 për shkak të pasurimit të pa bazë, duke llogaritur dhe kamatën ligjore nga dita e prurjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, e të gjithë këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar kundërpadinë e të paditurës Z.E, nga fshati “.....”, Komuna e Dragashit, të cilën e përfaqëson av. A.K nga Prizreni, përmes të cilës ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, Komuna e Dragashit, për shkak të pasurimit të pa bazë dhe të aprovohet kërkesëpadia nga kundërpadia si e bazuar dhe të obligohet paditësja që të paditurës Z.E të i kompensoj dëmin në shumën totale prej 14.500,00 €, duke filluar nga dita e

ushtrimit të kundërpadisë e deri në ditën e pagimit të tyre, si kërkesë tërësisht e pa bazuar, ndërsa në pikën III të dispozitivit ka vendosur që secili palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura-kundërpaditësja për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta ndryshoj dispozitivin I të aktgjykimit dhe të refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar apo ta prish të njëjtin aktgjykim në rigjykim dhe në rivendosje dhe dispozitivin nën II të aktgjykimit të ndryshohet dhe të aprovohet kërkespadia e të paditurit si të bazuar.

E paditura-kundërpaditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës-kundërpaditëses është **e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja-kundërpaditura Komuna e Dragashit, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të pasurimit të pabazë t'ia kthej shumën prej 6.634,70 €, të tëra këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Edhe e paditura Z.E, ka prashtruar kundërpadi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditësja-kundërpaditura Komuna e Dragashit që të obligohet paditësja që të paditurës Z.E të i kompensoj dëmin në shumën totale prej 14.500,00 €, duke filluar nga dita e ushtrimit të kundërpadisë e deri në ditën e pagimit të tyre, si kërkesë tërësisht e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit dhe kundërpadisë së të paditurës, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si në vijim: kërkesën për kthimin e mjeteve të paguara gabimisht të lëshuara nga ana e Kuvendit Komunal në Dragash- Drejtoria për Financa drejtuar të paditurës, listën e delegatëve të Kuvendit në Dragash që përfundon me numrin rendor 27, kartelën e nëpunësit në emër të N.O datë 11.09.2012, qarkullimi në emër të Z.E prej datës 01.01.2010 e deri më datë 31.10.2012, vendimi për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr.16/2008 për pagesën e stafit politik të komunës, kopja e gazetës 26 shtator, shkrim me titull "Gabimi teknik lë një këshilltarë të SDA-së 32 muaj pa pagesë, ekspertiza mjeko-ligjore e lëshuar nga Dr. N.F si dhe dëshminë e të njëjtit ekspert të dëgjuar edhe si dëshmitar në seancën e datës n149.11.209, lista e pagave për vitin 2010, 2011 me përfundime për muajin shtator 2011, (dhe prova të tjera si në shkresat e lëndës), në bazë të cilave gjykata ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.105/12 të datës 06.05.2020, me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe ka refuzuar kundërpadinë e të paditurës.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara ka konstatuar se padia e paditësit është e bazuar, ngase pas administrimit të provave ka vërtetuar se pas një gabimi teknik që është bërë në bazë të listave të pagave dhe llogarive bankare mes dy përfaqësuesve të Kuvendit Komunal të Dragashit edhe atë N.O dhe të paditurës Z.E mjetet monetare që do ti takonin asamblistit N.O janë bartur gabimisht në llogarinë e të paditurës, për saktësisht 32 muaj dy paga buxhetore. Po ashtu në bazë të pasqyrave bankare dhe dëshmitë e dëshmitarëve, gjykata ka vendosur si në aktgjykimin e ankimuar. Në anën tjetër ka rezultuar se kundërpadia e të paditurës nuk është mbështetur në prova materiale, për çka edhe e njëjta është refuzuar si e pabazuar. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së. *(më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykatës së Apelit i ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes rreth kërkesëpadisë së paditëses, e parashtruar kundër të paditurës, si dhe kundërpadisë së të paditurës, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, e si rezultat i kësaj drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, për të cilat arsye aktgjykimi i atakuar është dashur që të vërtetohet në tërësi. Gjithashtu, edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin, përkatësisht aktgjykimi është hartuar në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mos themelësinë e kërkesëpadisë dhe pathemelësinë e kundërpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mungesën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar në arsyetim të aktgjykimit, se duke pasur parasysh provat e administruara ka vërtetuar se ka pasur një gabim teknik që është bërë në bazë të listave të pagave dhe llogarive bankare mes dy përfaqësuesve të Kuvendit Komunal të Dragashit edhe atë N.O dhe të paditurës Z.E, ku mjetet monetare që do ti takonin asamblistit N.O janë bartur gabimisht në llogarinë e të paditurës, i cili fakt është vërtetuar edhe nga pasqyrat bankare dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, ku shihet që në xhirollogarinë e të paditurës janë bartur nga e njëjta linjë buxhetore për saktësisht 32 muaj dy paga buxhetore. Ndërsa pretendimet e të paditurës se është arsimitare në shkollën “9 Maji”, nuk qëndrojnë ngase nuk ka provë (kontratë punë), dhe pretendimet e saj nuk përputhen

me provat e administruara dhe të prezantuara. Andaj si rezultat i këtij gabimi ka ardhur deri të pasurimi i pa bazë i të paditurës, e cila edhe pse ishte e vetëdijshme se paga e saj është më e lartë se sa i takon sipas Udhëzimit administrativ, e njëjta ka heshtur duke tërhequr mjetet nga llogaria bankare për më se 32 muaj. Në anën tjetër, në lidhje me lartësinë e shumës dhe pasurimit të pa bazë, gjykata e shkallës së parë këtë e ka vërtetuar nga kartela e nëpunësit N.O, ku është vërtetuar shuma totale prej 6.634,70 €. Si rrjedhojë, duke pasur parasysh faktin se me provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme fakti se e paditura është pasuruar pa bazë, atëherë edhe me të drejtë është aprovuar kërkesëpadia e të paditëses si e themeltë. Në këtë drejtim, me nënin 194 par.1 të LMD-së, parashihet se: *“Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”*. Në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *“Fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve”*, ndërsa par.3 përcakton *“Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket”*.

Tutje, për Gjykatën e Apelit rezultoi si i drejtë dhe i ligjshëm refuzimi i kundërpadisë së paditurës për kompensim dëmi, ngase gjykata e shkallës së parë përmes provave të administruara ka vërtetuar drejtë se nuk ka bazë për aprovimin e të njëjtës, ngase të paditurës nuk i është shkaktuar kurrfarë dëmi në lidhje me cenimin e nderit dhe autoritetin për publikimet e ndryshme që janë bërë ndaj saj nëpër portaleve dhe mediave të ndryshme, si dhe ekspertizës së ekspertit nga lëmia psikiatrike gjykata nuk i fali besimi me arsyetimin se së është përgjithësuar dhe nuk përkon edhe frymën e provave tjera të administruara si dhe fajin e paditëses për dëmet eventuale që e paditura mund të ketë përjetuar. Prandaj, në mbështetje të lartcekurave, e konform paragrafit 1 të nenit 7 të LPK-së ku parashihet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe nenit 319 të po këtij ligji ku parashihet se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, nga të cilat del se pala e paditur nuk ka arritur ti provojë pretendimet e veta para gjykatës së shkallës së parë. Si rrjedhojë, përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, për Gjykatën e Apelit, rezulton si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që e paditura me asnjë provë nuk ka argumentuar se pretendimet nga kundërpadia.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449 dhe 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3880/2020, datë 28.04.2022

**Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka**